

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni vjeshtor**

Kryesia e Kuvendit  
P-042  
Prishtinë, më 2 dhjetor 2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 2 DHJETOR 2008

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa mungoi Sabri Hamiti.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Mufera Sinik, ndërsa munguan Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli dhe Bojan Stojanoviq.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skender Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI: Rinor Beka, dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 nëntor 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 nëntor 2008, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca e radhës të mbahet **më 11 dhjetor 2008**, me këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat individuale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen,
9. Rishqyrtimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët,
10. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Vendimin e Qeverisë së

- Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
  14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur të Mediave, dhe
  15. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave**

- 3.1 Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës

Kryesia vendosi që kjo pikë të radhitet për shqyrtim në seancë plenare më 4 dhjetor 2008.

- 3.2 Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin në rishqyrtim të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë

Kryesia, pasi shqyrtoi vendimin e Presidentit, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që t'i shqyrtojë vërejtjet e Presidentit të Republikës së Kosovës në Ligjin nr.03/L-110 "Për ndërprerjen e shtatzënisë" dhe në afatin brenda dy javëve Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

- 3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për kompensimin e punës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, vendosi që anëtarët Komisionit ad hoc dhe stafi i tij mbështetës të kompensohen për punën e tyre, sipas vendimit të mëparshëm për pjesëmarrje në punën e komisioneve ad hoc.

### **4. Të ndryshme**

**Kryetari** ngriti katër çështje: a) Vendimin i Kryesisë së Kuvendit për ndarjen e përgjegjësive të anëtarëve të Kryesisë; b) ndarjen e hapësirës-zyrave, të liruara nga Ministria e Transportit, për deputetët e Kuvendit, përfaqësuesit e NDI-it, të OSBE-së dhe

stafin e Administratës, c) çështjen e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, dhe d) mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Lidhur me mbylljen e avanceve, Kryesia nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Divizioni i Buxhetit i Administratës së Kuvendit që **t'i njoftojë me shkrim** deputetët, që kanë marrë avance për udhëtime zyrtare jashtë vendit, për t'i mbyllur avancet brenda dy javëve pas kthimit nga udhëtimi.

Kryesia mbështeti propozimet e Kryetarit që çështjet e ngritura më lart duhen të zgjidhen në afatin sa më të shkurtër të mundshëm, në bazë të përgjegjësive që kanë organet e Kuvendit, sipas Rregullores së Punës dhe akteve të tjera të Kuvendit.

**Slobodan Petroviq**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kundërshtoi diskutimin e Xhezair Muratit, në mbledhjen e mëparshme, lidhur me përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**